

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-109/13

Prishtinë,
19 mars 2014

Në çështjen juridike të:

M R
K 27 V
11 M
O
S

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

kundër

Nuk dihet

Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Esma Erterzi, Kryetare e Kolegjit, Dag Brathole dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, duke vendosur në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/176/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00171), të datës 24 tetor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 19 mars 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e M R kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/176/2012, të datës 24 tetor 2012.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/176/2012, i datës 24 tetor 2012, për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA00171.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 8 gusht 2006, M R ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit dhe ri-posedimin e një lokali në ngastrën nr. 1529, në zonën kadastrale të Kamenicës, në komunën e Kamenicës. Ai pohon se atij i ishte lejuar që të ndërtonte një objekt montazh të karakterit të përkohshëm në pronën shoqërore në atë ngastër. Lokali afarist ka një sipërfaqe prej 15 m².
2. Lokali afarist ndodhet në rrugën Adem Jashari në Kamenicë, ngastra nr. 1529. Paraqitësi i kërkesës ka kërkuar ri-posedimin e kioskës.
3. Për të mbështetur kërkesën e tij, ai ka paraqitur një kopje të vendimit nr. 01-06-353-1/95, të datës 18 janar 1995, të Komunës së Kamenicës. Kjo kopje e vendimit vërteton se paraqitësit të kërkesës i ishte lejuar që të vendoste një objekt të tipit montazh të karakterit të përkohshëm për përgatitjen e ushqimit të shpejtë dhe shitjen e ushqimit të grillit, afër kioskës ekzistuese që ishte në pronësi të A S. Ai po ashtu ka bashkëngjitur vendimin e Kuvendit Komunal të Kamenicës, të Drejtoratit për Urbanizëm, Strehim, Shërbime Publike dhe Ndërtim, numër 03-351-4/1, të datës 17 nëntor 1995 dhe një kopje të një kontrate tjetër me numër 03-464-018-L/98, për marrjen me qira të ngastrës kadastrale nr. 1529 në pronësi shoqërore, të regjistruar në fletën poseduese 431, KK e Kamenicës, rruga “Cara Lazara”, me sipërfaqe prej 24,91 m². Neni 2 i kontratës thekson se kjo kontratë është për një periudhë kohore të kufizuar, duke filluar nga data 1 janar 1998 dhe duke përfunduar më 31 dhjetor 1998, e cila nuk do të jetë e vlefshme pas kësaj kohe.
4. Kërkesa është regjistruar në AKP me numrin KPA00171. Kërkesa nuk është kontestuar.
5. Më 24 tetor 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK), nëpërmjet vendimit të vet KPPC/D/C/176/2012, e ka hedhur poshtë kërkesën në mungesë të juridiksionit. Në arsyetimin e vendimit të vet, KKPK-ja thekson se sipas provave të paraqitura nga paraqitësi i kërkesës, kërkesa ka të bëjë me pronë të luajtshme e jo më pronë të paluajtshme private. KKPK-ja thekson se juridiksioni i tij është i kufizuar në ri-posedimin e pronës së paluajtshme.
6. Më 15 mars 2013, vendimi i ishte dorëzuar paraqitësit të kërkesës M R dhe ai ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme më 11 prill 2013 (në tekstin e mëtejme: pala ankuese).

7. Në ankesën e tij, pala ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së bazohet në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të fakteve, dhe se nuk ka arritur të vërtetojë se objekti i ndërtuar ishte pronë e paluajtshme e jo pronë e luajtshme. Vendimi i kundërshtuar po ashtu mbështetet në zbatimin e gabuar të se drejtës materiale dhe procedurale.
8. Në anën tjetër, Gjykata Supreme vëren, në kërkesën drejtuar Administratës së Përkohshme të Komunës së Kamenicës më datën 8 gusht 2005, e cila është bashkëngjitur në këtë kërkesë, se paraqitësi i kërkesës e pranon se ai kishte filluar së shfrytëzuar objektin e tipit montazh që ndodhet në pronën shoqërore, ngastrën kadastrale nr. 1529, më 18 janar 1995. Fakti se prona është një objekt i tipit montazh nuk ishte kontestuar nga pala ankuese deri në atë kohë.

Arsyetim ligjor:

Pranueshmëria:

9. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç parashihet me ligj (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079). Gjykata Supreme ka juridiksion për këtë ankesë. Ankesa është e pranueshme.

Meritat e ankesës:

10. Pas shqyrtimit të shkresave të lendes dhe pretendimeve ankimore të palës ankuese, sipas dispozitave të nenit 194 të LPK-ës, Gjykata Supreme gjeti se ankesa është e pabazuar.
11. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka ta drejtë nga Komisioni në urdhër për kthim në posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon të drejtën pronësore, ose të drejtën e shfrytëzimit të pronës private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale dhe se ai ose ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojnë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershor 1999. Nga kjo dispozitë ligjore rezulton se, juridiksioni i Komisionit për Kërkesa Pronësore i AKP-ës dhe rrjedhimisht të Gjykatës Supreme është i kufizuar ekskluzivisht për zgjidhjen, gjykimin dhe vendosjen e kërkesave të së drejtës së pronësisë për pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën e paluajtshme bujqësore dhe komerciale.
12. Nuk është kontestuese se sipas vendimit nr. 01-06-353-1/95 të Komunës së Kamenicës të lëshuar më 18 janar 1995, paraqitësit të kërkesës i ishte dhënë leja për vendosjen e një objekti të karakterit të përkohshëm. Toka është përcaktuar si tokë shoqërore. Për më tepër, leja për shfrytëzim është lëshuar për një periudhë kohore të kufizuar, e që në dokumente duket të jetë 31 marsi 1998 për herë të fundit.
13. Gjykata Supreme konsideron se prona e kërkuar sipas dispozitës së nenit 9 paragrafit 1 të Ligjit për Pronësi dhe Drejtat tjera Sendore (Ligji nr. 03/L-154), trajtohet si send i luajtshëm. Sipas

kësaj dispozite ligjore, rezulton se ndërtesat e përkohshme të tipit montazh, kioskat dhe objektet tjera montazh të karakterit të përkohshëm, siç është rasti konkret, nuk konsiderohen sende të paluajtshme. Për më tepër, neni 14 par. 1 dhe neni 26 par. 2 të Ligjit për Tokën Ndërtimore (Gazeta Zyrtare e KSAK nr. 14/80) parashikon se kur organi kompetent e jep në shfrytëzim të përkohshëm për nevojat e përkohshme kërkuesve për vendosjen objekteve të përkohshme i tipit montazh, atëherë ai organi ka të drejtë që sipas nevojave të planit urbanistik ta dislokoj atë objekt me shpenzimet personale të shfrytëzuesit. Madje, objekti i përkohshëm nuk mund të jetë çështje e pranimi të drejtës së pronës e as që mund të regjistrohet në regjistrin e pronësisë së zyrës për kadastër. Prandaj, në përputhje me paragrafin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, KKPK-ja nuk ka juridiksion që të vendos për pronat e luajtshme.

14. Prandaj, vendimi i kundërshtuar nuk përmban ndonjë gabim të rëndë apo moszbatim serioz të së drejtë materiale dhe procedurale.
15. Ky aktgjykim nuk përjashton dhe kufizon të drejtën e paraqitësi të kërkesës për t'i kërkuar të drejtat e tij në gjykatat kompetente.
16. Nga sa u tha më lartë dhe sipas neni 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut e plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

17. Në përputhje me neni 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Esma Erterzi, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Dag Brathole, Gjyqtar i EULEX-it

Shukri Sylejmani, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it